



Pranuar / Dorezuar Emiljen/Prilozhen Received/Delivered	06.10.2023	3	viti god year
Organ Njësia Organ /Jednitsa Org./Unit	Nr Prot Nr Prot Prot No	Shtojca Prillog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRAMSHEK	6418/2023		112



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.1119/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1119/2023 të datës 28.08.2023 e parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "Kërkese nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.10.2023 mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1119/2023 të datës 28.08.2023 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja, me datë 28.08.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 6152/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me nr.ref 262/23, të datës 31.07.2023 për sistemim të përhershëm pas përfundimit të mandatit të nxjerr nga Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Në proces të shqyrtimit të ankesës nga këshilli ankuesja më datë 05.10.2023 përmes shkresës me numër protokollit 6413/2023, ka tërhequr ankesën A.nr.1099/2023 të datës 21.08.2023, me arsyetimin se më datë 05.10.2023 i është bërë transferimi në pozitën komform përgatitjeve profesionale ku ankuesja ka dhënë edhe pëlqimin e saj.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës me numër protokollit 6413/2023 të ankueses për tërheqje nga ankesa, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ,

siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", dhe si rrjedhojë në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1119/2023 të datës 28.08.2023, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi..

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1119/2023.

Ilire **MEHMETI-SHAQIRI**

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dërgohet

- Ankuese,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

Malsore **GASHI-BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

